



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P. nr.40/17**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit B. G , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II nr.2576/16 të dt. 13.1.2017, për vepër penale të kryer në bashkëveprim : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit B. G dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi me dt.15.2.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri B.G i lindur me dt.23.12.1992 në P, rruga D, i biri i A dhe nënës S e gjinisë D , Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

### **ËSHTË FAJTORE**

**Për shkak se :**

Me dt. 10.11.2015 , rreth orës 16:00 , në Pejë , pikërisht te fusha e sportit te qendra e mjekësisë familjare në Pejë , me mjet që mund të shkakton lëndime të rënda trupore , tjetrit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore , dhe atë të dëmtuarit K. ( M ) B , në atë mënyrë që , ditën kritike pas një fjalosje të çastit , të pandehurit e godasin me grusht dhe shqelma në pjesët e ndryshme të trupor , dhe derisa i dëmtuari ishte duke u larguar në drejtim të shtëpisë së tij , në afërsi të shkollës Asdreni i shkojnë nga pas, ku të pandehurit e godasin me një mjet të fortë hekuri prapa shpine , dhe i shkaktojnë lëndime të lehta trupore në regjionin e shpatullës së djathtë , në regjionin e pasmë të majtë të gjoksit , në regjionin e buzës së sipërme të gojës , në regjionin e njijsës talokulare të djathtë dhe largohen nga vendi i ngjarjes .

-me çka ka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale të kryer në bashkëveprim :lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 188 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. **I SHQIPTON**

### **DËNIM TË KUSHTËZUAR**

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.13.1.2017 kundër të pandehurve R.B dhe B. G ka ngritë aktakuzë PP/II.nr.2576/16, për vepër penale të kryer në bashkëveprim : lëndim i është trupor nga neni 188 par 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurit ti shpallë fajtorë , ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Me dt. 15.2.2018 gjykata e ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin janë paraqitur i pandehuri B. G , nuk ka ardhur i pandehuri R.B kurse nga stacioni policorë në Pejë me raport na kanë njoftuar se i njëjti nuk po mund të gjendet dhe nuk i dihet adresa e sakët -, për çka gjyqtari për shkak të ekonomizimit të procedurës e ka bërë edhe veçimin e procedurës- duke formuar lëndë të re për të pandehurin R. B

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri B.G – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shteti e ka pranuar , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë e ka pranuar

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë , gjendjen e varfër ekonomike , moshën mjaftë të re , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së

Vlen të cekët se i dëmtuari Kreshnik Berisha në vitin 2017 ka ndërruar jetë si pasojë e një aksidenti në trafik

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.15.2.2018.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .